



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 641/4 Prot.

Tiranë, më 02.11.2020

**V E N D I M**

Nr.141, datë 02.11.2020

**Mbi arkivimin e kërkesës së regjistruar me nr. 641 prot., dt. 20.7.2020, dhe nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020, dërguar prej Kryetarit të Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në një procedurë për pranim në TND.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e pretendimeve të ngritura nga Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet informacionit/kërkesës të regjistruar me nr. 641 prot., datë 20.7.2020 dhe nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020, Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, ka parashtruar se pranimi në trupën e nivelit të lartë drejtues (TND), i nëpunësit \*\*\*\*\*\*, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, është bërë në shkelje të kriterëve të ligjit e për këtë arsye kërkohet rivlerësimi i procesit dhe lirimi i tij nga detyra. Ky informacion i është dërguar në të njëjtën kohë edhe Departamentit të Administratës Publike, Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, Ministrisë së Drejtësisë, si dhe, Kryeministrisë në vëmendje.

Departamenti i Administratës Publike, i cili në bazë të përcaktimeve të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është i ngarkuar me organizimin e procedurës së pranimit në TND, pasi është njohur me pretendimet e parashtruara në kërkesë, me anë të shkresës nr. 3127/2 prot., datë 27.7.2020, ka informuar Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë lidhur me tërësinë dhe rendin e veprimeve administrative të kryera për realizimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2019; gjendjen e plotësisimit të kriterëve për pjesëmarrje në këtë konkurs nga ana e konkurrentit \*\*\*\*\*; vlerësimin nga KKP për kandidatin në fjalë me mbi 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit; si dhe, procesin e shpalljes së tij fitues, në përfundim të krejt procedurës së konkurrimit.

Gjithashtu, Departamenti i Administratës Publike në përgjigjen e tij sqaron se, për procesin e emërimit të shtetasit \*\*\*\*\* , në një pozicion të nivelit të lartë drejtues në aparatën e Ministrisë së Drejtësisë, është kryer një hetim administrativ nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili në përfundim të shqyrtimit ka vendosur arkivimin e çështjes, pasi procesi në fjalë është vlerësuar se është kryer në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (*shkresa nr. 1528/4 prot., datë 12.12.2019, "Njoftim mbi arkivimin e kërkesës", e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*).

Konstatohet se, edhe pasi është njohur me sqarimet si më sipër, informuesi/kërkuesi ka vazhduar të pretendojë se \*\*\*\*\* , nuk plotëson kriteret për t'u pranuar në trupën e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese (TND) e për këtë arsye i ka dërguar një informacion të dytë DAP dhe Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në (*shkresa nr. 712 prot., dt. 6.8.2020*), bashkë me disa materiale shkresore të marra pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të cilat përmbajnë të dhëna lidhur me periudhat e mëparshme të punësimit, të shtetasit \*\*\*\*\*.

Informacioni i dytë, i është dërguar për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (*regjistruar me nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020*), Ministrisë së Drejtësisë, Misionit Euralius V dhe Kryeministrisë në vëmendje.

Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr. 4501/3 prot., datë 11.8.2020, ka sqaruar informuesin/kërkuesin se, rekrutimi i \*\*\*\*\* , në një pozicion të kategorisë së lartë drejtuese të shërbimit civil, në këtë institucion është bërë nëpërmjet procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2019. Këto procedura kryhen nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes për TND-në, pranë Departamentit të Administratës Publike, prandaj për çdo pretendim lidhur me këtë emërim duhet t'i drejtohen Departamentit të Administratës Publike.

Duke parë përmbajtjen e informacioneve/kërkesave të paraqitura në rastin objekt trajtimi, të regjistruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, me nr. 641 prot., dt. 20.7.2020 dhe nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020, rezulton se në to ngrihen në mënyrë të përsëritur, pretendime se në procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2019, të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, ku është shpallur fitues kandidati \*\*\*\*\* , janë lejuar interpretime dhe vlerësime të pasakta të fakteve dhe të legjislacionit, të cilat kanë sjellë si rrjedhojë këtë emërim të paligjshëm.

Konkretisht, përsëritet informacioni se, kandidati në fjalë nuk plotëson kushtet e karrierës dhe eksperiencës për pranimin në TND, pasi periudha e punësimit të tij në INSIG Sha, nuk mund të konsiderohet si punë në administratë shtetërore, pasi kjo organizatë, pavarësisht se zotëronte kapital shtetëror, për efekt të ligjit ka qenë një shoqëri tregtare dhe shoqëritë tregtare veprojnë në bazë të ligjit nr. 9901, dt. 14.4.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*". Gjithashtu, sipas informuesit edhe periudha e punësimit si këshilltar pranë Ministrisë së Drejtësisë, nuk duhet të konsiderohet e barasvlershme me një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese në shërbimin civil, për arsye se ligji e thotë qartë se funksionari i kabinetit nuk ushtron kompetencë drejtuese ose autoritet publik.

Pas shqyrtimit të këtyre pretendimeve, konstatohet se ato (*pretendimet e paraqitura në informacionin/kërkesën e dërguar nga Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të*

*Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, regjistruar me nr. 641 prot., datë 20.7.2020 dhe nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020), janë të njëjta me pretendimet e paraqitura në një kërkesë të mëparshme pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, protokolluar me nr. 1528 prot., datë 22.10.2019, për të cilat pas kryerjes së procesit të verifikimit dhe vlerësimit të fakteve të përmendura, është arritur në përfundimin se në rastin e këtij procesi pranimi në TND nuk janë gjetur shkelje të asaj natyre që mund të sillnin pavlefshmëri të procesit, përgjigje e cila i është njoftuar të interesuarve me shkresën nr. 1528/4 prot., datë 12.12.2019, “Njoftim mbi arkivimin e kërkesës”. (Një kopje e kësaj shkrese i bashkëlidhet këtij vendimi).*

Sa më sipër, duke qenë se në informacionet/kërkesat e paraqitura nga Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, nuk parashtrihen fakte apo rrethana të reja të cilat mund të vinin në dyshim rezultatet e verifikimit dhe vlerësimit të mëparshëm, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil bazuar në nenin 16, pika “10”, të Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, arrin në përfundimin që edhe ky informacion të arkivohet.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 16, pika “10”, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të arkivohen informacionet/kërkesat e regjistruara me nr. 641 prot., dt. 20.7.2020, dhe nr. 641/1 prot., datë 7.8.2020, dërguar nga Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në procedurën e pranimi të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2019, të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, pasi një kërkesë me të njëjtin objekt, është trajtuar edhe më parë nga Komisioneri.
2. Të njoftohet për këtë vendim Kryetari i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, Ministria e Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**